

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Krimeve të Rënda, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët Afrim Shala, kryetar i trupit gjykues, Naser Maliqi dhe Venhar Salihu, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Fikrete Destani, në çështjen penale ndaj të akuzuarit B. P., nga fshati K., Komuna e Gj., për shkak të veprës penale grabitje, nga neni 329 paragrafi 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), të cilin sipas autorizimit e mbron avokati S. M., nga Gj., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.I.nr.146/2014, e datës 18 korrik 2014, të cilën e përfaqësonte prokurori Afrim Shefkiu, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 20 maj 2016, mori dhe publikisht shpalli, kurse, më 31 maj 2016, e përpilojë me shkrim këtë :

## A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit B. P., nga babai L. dhe nëna M., e lindur R., i lindur më ... , në fshatin K., Komuna e Gj., ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pamartuar, punëtor sigurimi në Kompaninë "...", i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme,

## REFUZOHET AKUZA

Sepse kinse me datën ... 2014, rreth orës ... minuta, në rrugën "...” në objektin banesor ( te ...) në Gj., ka kryer grabitjen në dëm të dëmtuarit S. I., nga Gjilani me qëllim që vetit t’i sjell dobi pasurore të kundërligjshme, me përdorim të forcës dhe kanosjes serioze për të sulmuar jetën dhe trupin e të dëmtuarit e duke shfrytëzuar edhe moshën e të njëjtit, fillimisht e ka goditë me grushte në fytyrë e më pastaj e kërcënon edhe me një thikë duke e detyruar të dëmtuarin që t’ia dorëzojë të gjitha të hollat që i kishte edhe atë 1.320 Euro, 100 Franga Zvicerane dhe 14 Dollarë Amerikan dhe largohet në drejtim të panjohur, kurse, me punën operative të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës, Njësi i Hetimeve Kriminale në Gjilan, hetohet dhe zbulohet,

-me këtë kishte për të kryer veprën penale grabitje nga neni 329 paragrafi 1 të KPK.

I dëmtuari S. I., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj Gjykate.

## Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të akuzuarit B. P., nga fshati K., Komuna e Gj., për shkak të veprës penale grabitje, nga neni 329 paragrafi 1 të KPRK.

Gjatë fjalës përfundimtare, prokurori i shtetit Afrim Shefkiu, ka deklaruar se pas rikonstruimit të vendit të ngjarjes dhe veçmas pas shikimit të video incizimit nga vendi i ngjarjes, ka rezultuar se deklarata e të dëmtuarit S. I. nuk përputhet me video incizim nga vendi i ngjarjes, si dhe rikonstruimin e vendit të ngjarjes, kështu që në mungesë të provave është tërhequr nga akuza ndaj të akuzuarit B. P., nga fshati K., Komuna e Gj., për shkak të veprës së lartcekur penale.

Andaj, meqë prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza pas hapjes së shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues duke u bazuar në nenin 363 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të KPP, e refuzoi akuzën PP.I.nr. 146/2014, të datës 18 korrik 2014.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore-juridike është udhëzuar në kontest civil, duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 3 të KPP, kurse, vendimi lidhur shpenzimet e procedurës penale, është marrë duke u bazuar në nenin 454 paragrafi 1 të KPP.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Krimeve të Rënda

Më 31 maj 2016

Sekretarja juridike,  
Fikrete Destani

Kryetari i trupit gjykues,  
Afrim Shala

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.